



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 12.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: në proces
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Kolegji i Posaçëm i Apelit (këtu e më poshtë KPA). Objekti: Shqyrtimi i ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, kundër vendimit nr. 32, dt. 05.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Bashkim Dedja		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca dëgjimore publike, u zhvillua në intervalin kohor 10:00-15:25, dhe u shty për në dt. 13 dhjetor. Shtyrja e seancës u bë për efekt të përgatitjes së diskutimeve përfundimtare . Përpos këtij fakti, seanca gjyqësore u ndërpre dy here, përkatësisht në intervalin kohor 1 orë në ndërprerjen e parë dhe 1 orë e 10 min në ndërprerjen e dytë.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të	Vendimi nuk u shpall në seancën publike të ditës së monitoruar. Shqyrtimi i çështjes është në proces, dhe seanca u shty për ditën e nesërme në orën 15:00 me qëllim përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqësore (emrat)	Ardian Hajdari - Kryesues i trupit gjyqës; Luan Daci - Relator i çështjes; Albana Shtylla, Ina Rama dhe Rezarta Schuetz - anëtarë të trupit gjyqës; te pranishëm pa shkëputje deri në përfundim të seancës gjyqësore		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar u paraqit znj. Mia Raising; E pranishme pa shkëputje deri në përfundim të seancës gjyqësore		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht	Mbrojtja u realizua me përfaqësimin ligjor te Av. Maks Haxhia		
Pala ankimuese (Komisionerët Publik/Subjekti i rivlerësimit) (gjeneralitetet)	Komisioneri Publik relatives i çështjes:Darjel Sina		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri i anëtarëve nga publiku u konstatua të jetë gjithëpërfshirëse, me rreth 30 persona, përfaqësues të institucioneve publike të interesuara, të shoqërisë civile, Avokatit të Popullit, dhe stafit të këshilltarëve ekonomik dhe ligjor të KPA dhe Komisionerëve Publik, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye ne formë të rregullt nga stafi koordinues i KPA, pavarësisht hapësirës së kufizuar të sallës së gjykimit.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme,me akses të plotë ne hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës iu komunikua nga kryetari i trupit gjyqës, të largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar Rregullores "Për marrëdhëniet me median".		

C. A vendosi pala ankimese të parashtror pretendime për të tre kriteret ligjore të Vettingut?	Po/Jo	Në cilat prej tre kriterëve ligjore u ndalua pala ankimese (komisionerët publik) në prezantimin e shkaqeve të pretendimeve? Specifikoni kërkesat përfundimtare (pretendimet).	Cili është reagimi i subjektit të rivlerësimit ndaj pretendimeve të Komisionerit publik? Specifikoni kërkesat përfundimtare (prapësimet). Specifikoni nëse ka bërë Apel kundërshtues.
	jo	Pala ankuese, përfaqësuar nga Komisioneri publik z. Darjel Sina, investoj të drejtën e ankimit si pasojë e rekomandimit të ONM, dhe pretendoj se janë konstatuar mangësi në gjendjen që janë aktet, sa i takon vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit. Kërkesat përfundimtare të parashtruara: ndryshimin e vendimit të KPK dhe aplikimin e masës disiplinore shkarkim nga detyra	Subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësimet e tij duke e cilësuar vendimin e KPK të drejtë, dhe duke kërkuar përfundimisht "lënien në fuqi të vendimit të KPK, që ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë". Deklaroj se ka marrë dijeni për Vendimin dhe shkaqet e ankimit
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Prezantimi i pretendimeve/prapësimeve	pala që ka parashtruar pretendimin	A u diskutua? Specifikoni aktet provuese të administruara? Specifikoni barrën e provës ?
D1. Pasuria	Shkaqet e pretendimeve parashtruar nga Komisionerët Publik, lidhur me vlerësimin e pasurisë: 1- Apartament banimi, Tiranë, pjesë takuese 100%. Burim krijimi: Kursime personale + të ardhura të tjera në vlerën, 11.600 Eur. Ndërkohë në deklaratën e vitit 2003, kjo pasuri rezultonte në pjesë takuese 50% bashkëpronar me të vëllain, dhe me burim krijimi: kursime personale dhe të vëllait. Sipas palës ankuese, ka paqartësi në ligjshmërinë e burimit të krijimit dhe të pjesëve takuese, si pasojë e mospërputhjeve të Deklaratës Vetting dhe atyre vjetore. I vëllai që ka paguar rreth 90% të vlerës së pasurisë, vërtetohet se nuk ka qenë në marrëdhënie punësimi në çastin e shlyerjes së tarifës. 2- Apartament banimi, Tiranë, vlera 180.000 Eur. Burim krijimi: kredi bankare+ hua pa interes nga i vëllai dhe kunati. Sipas komisionerit, subjekti duhet të paraqes dokument justifikues ligjor për të ardhurat e personave që i kanë dhënë hua. Deklaratat e punësimit e punëdhënësit të vëllait në shtetin grek, nuk mjaftojnë për të ligjëruar këto të ardhura. Gjithashtu komisioneri ngre dyshimin e faktit që subjekti ka preferuar të marrë hua, kur mund të shiste pasuri të tjera në pronësinë e tij. 3- Shtëpi banimi, Kavajë, Golem. ZVRPP Kavajë konfirmon si pronar të ligjshëm të tij vëllain e subjektit, ndërkohë rezulton që kontrata e furnizimit me energji elektrike është e lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit. Të argumentohet e drejta e banimit që ka subjekti mbi këtë pasuri.	Komisioneri Publik	Provat e administruara në seancën dëgjimore: Pozita procedurale e Komisionerit Publik, i rezervon të drejtën të paraqes kërkesë për marrjen e provave që nuk janë administruar nga KPK, pa pasur barrën e provës për të vërtetuar pretendimet e tij.
	Prapësimet paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, kundër shkaqeve të pretendimeve parashtruar nga Komisionerët Publik, lidhur me vlerësimin e pasurisë : 1- Lidhur me huanë e marrë nga i vëllai, hodhi pretendimin se nuk i ka kaluar barra e provës nga KPK. 2- Lidhur me të ardhurat e të vëllait, ka paraqitur vërtetim punësimi nga punëdhënësi subjekt privat në shtetin grek, dhe ministria e brendshme greke (për faktin që puna është kryer pranë një subjekti privat, dokumentimi mund të realizohet vetëm nëpërmjet një vërtetimi të thjeshtë). Kjo pasi i vëllai ka punuar në emigracion, dhe është fakt i njohur botërisht që për vite të caktuara shqiptarët sillnin të ardhura nga punësimi në emigracion. Po në këtë linjë ka punuar edhe i vëllai, si emigrant i paligjshëm për disa vite (deri në 1998), arsye që e bën të pamundur dokumentimin e marrëdhënieve të punës apo pagës së marrë, (të cilat shteti shqiptar i ka konsideruar të ligjshme. Buxheti i shtetit ka zë të veçantë për të ardhurat që sjellin emigrantët), si dhe të formalizimit të taksave (pagesa kryhej me para në dorë dhe jo nëpërmjet sistemit bankar). Megjithatë ky fakt nuk mohon punën e ligjshme të kryer si edhe përfitimim e vlerave monetare të mjaftueshme për të mbuluar vlerën e apartamentit të blerë (ILDKPI e ka njohur këtë kontribut të ardhurash si të ligjshëm). Pas martesës, i vëllai nuk kishte më interes për tu kthyer ne Shqipëri, për këtë arsye investimi i pallatit të blerë i ngeli në pronësi të plotë subjektit të rivlerësimit. Kjo është arsyeja pse apartamenti figuron në vite të ndryshme me pjesë të ndryshme takuese. Subjekti pretendon se edhe pa kontributin e të vëllait, shumta e të ardhura të vërtetuara të tij, është e mjaftueshme për të përbulluar këstet bankare. Gjithashtu të ardhurat që dokumentohen të vëllait dhe bashkëshortes së tij, janë rreth 394.818 Eur, që është vlerë e mjaftueshme monetare për të paguar vlerën e një apartamenti në Tiranë (10 milion Lek) 3- Lidhur me Apartamentin në Kavajë, Golem, subjekti deklaroi se nuk ka të drejta reale mbi të, pasi figuron në pronësi të vëllait, dhe nga ai përdoret vetëm e drejta civile e banimit, në periudhën e verës. Pagimi i energjisë elektrike është kryer nga subjekti, pasi i vëllai, pronar efektiv i pasurisë, nuk kishte mundësi të kryente procedurën për arsye të largësisë së banimit. Kryerja e kësaj procedure për lehtësi pagimi, nga subjekti, nuk mund të jetë burim krijimi i të drejtës së pronësisë mbi këtë pronë, siç pretendon komisioneri 4- Komisioneri nuk mund të pretendoj se i vëllai për efekt të ligjit cilësohet si person tjetër i lidhur. Pasi ligji e lidh këtë cilësim vetëm për huadhënësit dhe dhuruesit, dhe është shëruar, duke mos e lidhur me format e tjera të përfitimim të të ardhurave. 5- Komisioneri nuk mund të aludojë, që për të blerë një pasuri subjekt nuk duhet të marrë hua por të kondicionohet të shesë pasurinë vetjake (për më tepër që pasuria se cilës i referohet, është e vjetër dhe praktikisht e pashfrytëzueshme për tu shitur) 6- Apartamenti është blerë 18 milion dhe jo 116 milion lek siç pretendon komisioneri, pasi duhet ti referohemi sistemit të vlerësimit të kohës së tjetërimit të pasurisë 7- Pretendohet ekzistenca e konfliktit të interesit në gjykim, pasi Komisioneri relator i çështjes, z. Sina, ka qenë në cilësinë e konkurrentit si anëtar në Gj. e Strasburgut, në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i jurisë që përkatësisht ka votuar kundra kërkesës së tij.	Subjekti i rivlerësimit	Aktet provuese të paraqitura në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit: 1. vërtetim punësimi nga punëdhënësi subjekt privat në shtetin grek, dhe ministria e brendshme greke.

		Mbrojtja	
		Ankesa nga publiku	
	Parashtron pyetjen: Përse duhet që kontrata me OSHE për pagimin e energjisë elektrike të jetë në emrin e subjektit, kur mund të jetë nën emrin efektiv të pronarit të ligjshëm të saj, dhe pagesa të kryhej nga subjekti si banues i kësaj pasurie	Përfaqësuesi i ONM	
	Çmon provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit si të panevojshme, dhe refuzon marrjen e tyre	Relatori	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar		Komisioneri Publik	
		Mbrojtja	
		Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
		Përfaqësuesi i ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës		Komisioneri Publik	
		Mbrojtja	
		Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
		Përfaqësuesi i ONM	
komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut	Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Elementet procedural të procesit gjyqësor, referuar nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, janë respektuar. Kryetari i trupit gjykues parashtron procedurën e seancës dëgjimore. I jepet e drejta procedurale subjektit të rivlerësimit për të kundërshtuar pretendimet e Komisionerëve Publik. Njoftohet dhe pranohet në seancë, se ka marrë dëgjim lidhur me vendimin dhe shkaqet e ankimit. I rezervohet e drejta e pyetjes vëzhguesit ndërkombëtar dhe trupës gjykuese. Në përfundim të seancës gjyqësore, trupi gjykues mori vendim të ndërmjetëm, ku mori në shqyrtim vleftësimin e provave të paraqitura nga pala (subjekti, pasi komisioneri nuk paraqet prova por vetëm kërkon), duke vendosur mospranimin e tyre. Është ne kompetence të trupës gjykuese të cilësoj provat si të nevojshme ose jo, duke pare rendësin apo vërtetësinë e tyre, dhe vendos sipas bindjes së brendshme. Ligji nuk e detyron gjyqtarin të shprehet me vendim të motivuar për çdo vendim të ndërmjetëm, por i ngarkon përgjegjësinë të arsyetoj vendimin e ndërmjetëm në vendimin përfundimtar.		